

KOMUNA E KAMENICËS

2017: PROBLEMET

KRYESORE DHE TRENDET

BUXHETORE

Hyrje

Kryetar i Komunës së Kamenicës është Begzad Sinani (PDK), i cili u zgjodh më 2013 në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune. Ky është mandati i dytë qeverisës i z.Sinani, pas atij të 2007-2009. Para balotazhit, PDK hyri në koalicion me AAK dhe AKR, me të cilat ndan pushtetin ekzekutiv në komunë.

Sipas sondazheve të UNDP¹, të cilat janë më gjithëpërfshirëset në nivel lokal, kënaqshmëria e qytetarëve të komunës me qeverisjen lokale ka rënë dukshëm më 2015. Në krahasim me vitin 2012, ka një rënie të pakënaqësisë për 12 pikë. Rreth 56% e qytetarëve të komunës së Kamenicës besojnë se Komuna nuk është fare e përgjegjshme dhe nuk i merr parasysh shqetësimet e tyre.

Sa i përket rendit dhe sigurisë publike, Komuna e Kamenicës është një ndër komunat më të qeta. Në anketën e UNDP, përqindja e qytetarëve të cilët kanë shprehur se krimi dhe mungesa e sigurisë personale është problem në këtë komunë ishte zero.

Si problem madhor për 9.5% të qytetarëve të anketuar është korrupsioni. Kjo e fut Komunën e Kamenicës në mesin e 13 komunave ku problemi i korrupsionit është më i theksuar. Problem tjetër i cili është shqetësues për qytetarët e komunës së Kamenicës është edhe furnizimi e ujë. Edhe pse vetëm 3% e

¹ UNDP Kosovo. Kosovo Mosaic 2015. Burimi: <http://bit.ly/2wkuTnr> (hapur së fundmi më 22 korrik 2017).

qytetarëve kanë potencuar si problem furnizimin me ujë, kjo e fut Kamenicën në mesin e tetë komunave me nivelet më të larta të pa kënaqshmërisë së qytetarëve me furnizimin me ujë. Pas Komunës së Shtërpçës, Kamenica është komuna e dytë me nivelin më të lartë të pa kënaqshmërisë së qytetarëve me gjendjen në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Po ashtu, Kamenica është një ndër pesë komunat ku qytetarët kanë shprehur nivelet më të larta të pa kënaqshmërisë me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Më 2013, përmes hulumtimeve kualitative, intervistave me anëtarë të shoqërisë civile, gazetarë, anëtarë të partive dhe njohës të zhvillimeve lokale, GAP ka identifikuar pesë problemet kryesore në Komunën e Kamenicës.² Gjatë mandatit të tanishëm, qeveria lokale ka bërë shumë pak në trajtimin e problemeve të identifikuara më 2013. Madje për këto katër vite, komuna ka lejuar edhe degradimin e dy gjërave të cilat ishin vlerësuar pozitivisht nga qytetarët, ruajtja e të cilave ishte përgjegjësi e komunës, siç janë ruajtja e hapësirave të gjelbëruara në qytet dhe toka bujqësore në pjesën që njihet si "rrafshi i Topanicës".

Duke u bazuar në të dhënat kuantitative të UNDP, Instituti GAP përmes hulumtimeve kualitative, ka identifikuar problemet konkrete në komunën e Kamenicës, të cilat kërkojnë vëmendjen e qeverisjes komunale, pas zgjedhjeve lokale të 2017. Përveç identifikimit të problemeve konkrete komunale, Instituti GAP ka monitoruar edhe qasjen e Komunës ndaj pesë problemeve të identifikuara më 2013.

Problemet kryesore në Komunë

Gjendja jo e mirë në infrastrukturën e shkollave dhe në kualitetin e arsimit
Komuna e Kamenicës ka 43 objekte shkollore. Janë dy institucione parashkollore, një në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën serbe. Janë gjithsejtë 34 objekte të shkollave në gjuhën shqipe, 32 fillore dhe dy të mesme. Shkollat e mesme kanë paralele të ndara edhe në fshatrat Hogosht dhe Roganë. Deri para pak kohësh, shkolla e Roganës zhvillonte mësim në tri ndërrime, por ky problem është evituar. Janë edhe gjashtë shkolla fillore dhe dy të mesme në gjuhën serbe. Gjatë viteve të fundit, ka pasur shumë pak investime në infrastrukturën shkollore. Pjesa më e madhe e territorit të komunës shtrihet në pjesën malore dhe për shkak të largimit të popullatës, numri i nxënësve ka rënë dukshëm. Në shkollën e Lisockës, një objekt masiv i ndërtuar në fund të viteve '70, sot ndjekin mësimin vetëm 20 nxënës, tre apo katër nxënës në një klasë. Në shkollën paralele të fshatit Meshinë janë vetëm tre nxënës, në fshatin Kranidel janë katër nxënës, në

² Instituti GAP. Komuna e Kamenicës: problemet kryesore dhe trendet buxhetor.
Burimi: <http://bit.ly/2w6eaFc> (hapur së fundmi më 15 korrik 2017).

Dazhnicë katër nxënës, etj. Janë gjithsejtë 10 shkolla të tilla të cilat kanë më pak se 25 nxënës. Numri i vogël i nxënësve rrit koston e angazhimit të personelit, mirëmbajtjes, furnizimit të shkollave, etj. Po ashtu, për shkak të kushteve jo të mira në shkolla, vështirësohet edhe zhvillimi normal i orëve mësimore. Komuna nuk ka arrit të siguroj transport për nxënësit, të cilët duhet të ecin me orë të tëra për të arritur tek objekti më i afërt shkollorë, dhe këtë rrugë e kalojnë në një terren të vështirë dhe të pasigurte. Përveç në fshatrat e thella malore, gjendja në objekte shkollore nuk është e mirë as në fshatrat më të ulëta dhe në qytet. Objekti i shkollës fillore "Fan Noli", e cila ndan oborrin me shkollën e mesme serbe, është thujse i shkatërruar.

Në sistemin arsimor të komunës së Kamenicës problem paraqet edhe keqpërdorimet e shumta në rekrutimin e stafit dhe ndarjen e orëve. Për shkak të numrit të madh të mësimdhënësve të angazhuar, norma e punës në mesatare është nën 40 orë në javë. Ka ankesa të shumta për punësim të mësimdhënësve mbi baza familjare, partiake dhe mësimdhënës të pakualifikuar. Po ashtu, duke u munduar të sistemojë sa më shumë mësimdhënës në shkolla, komuna ka rritur numrin e punonjësve në shkolla, duke ua ulur normën mësimore.

Ndërtimet pa leje, humbja e hapësirave gjelbëruese dhe tokës bujqësore.

Në vitin 2013, të intervistuarit nga Instituti GAP kishin përmendur gjelbërimin dhe tokën bujqësore në "rrafshin e Topanicës" si dy fusha të cilat do të duhej që Komuna të angazhohej në ruajtjen e tyre. Por, pas katër vitesh, këto dy gjëra pozitive, janë shndërruar në problem. Në tokën bujqësore në "rrafshin e Topanicës", e cila gjendet mes fshatrave Koretin dhe Topanicë, kanë filluar ndërtimet pa leje, pa u penguar nga komuna. Po ashtu, në qendër të qytetit, përball ndërtesës së vjetër të administratës së komunës, ka filluar ndërtimi i papenguar i një objekti në kundërshtim me rregullat e ndërtimit.

Përveç kësaj, edhe pse në Komunën e Kamenicës ndërtimet janë në shkallë më të ulët se sa në komunat tjera më urbane, pjesa më e madhe e ndërtimeve bëhen pa leje, kurse inspektorati i komunës nuk intervenon në ndaljen e tyre. Kjo ka ndikuar edhe në rënien e vazhdueshme të të hyrave nga taksa komunale për ndërtim.

Furnizimi jo i mirë me ujë

Shumë vendbanime në territorin e Kamenicës nuk kanë furnizim të rregullt me ujë. Një ndër pesë problemet kryesore të cekura në raportin e GAP për problemet e Komunës së Kamenicës më 2013 ka qenë edhe mos funksionimi i ujësjellësit në fshatin Koretin. Edhe më 2017, ujësjellësi nuk është funksional, edhe pse janë investuar 283 mijë euro, që në mandatin e parë të z.Sinani (2009). Në gusht të 2017 është paralajmëruar se punimet do të rifillojnë në funksionalizimin e ujësjellësit, por edhe më tej banorët nuk kanë furnizim me ujë. Gjatë mandatit 2014-2017 është investuar vetëm në ujësjellësin në lagjen

“Çamëria” në qytet, si dhe janë ndarë edhe 30 mijë euro për ujësjellës në fshatra. Ujësjellësi në fshatin Topanicë menaxhohet nga vetë banorët, ngase kompania rajonale e ujësjellësit dhe komuna nuk kanë shprehur interesim në menaxhimin e tij. Problem me furnizim me ujë përveç në fshatin Koretin janë raportuar edhe në fshatrat Kopernicë, Roganë dhe Muqiverc.

Kundërmimi nga ujërat e zeza

Ashtu sikurse në vitin 2013, edhe këtë vit të intervistuarit nga Instituti GAP kanë cekur si problem kundërmimin na ujërat e zeza, sidomos në fshatrat Koretin dhe Berivojcë. Në gusht të 2017, komuna ka filluar largimin e mbeturinave në pjesën e fshatit Koretin, por sipas banorëve kjo nuk do e zgjidh problemin e ujërave të zeza. Edhe më tej ujërat e zeza dhe mbeturinat hedhen në shtratin e lumit. Banorët e fshatit Koretin janë vetëorganizuar duke angazhuar dy persona të cilët përkujdesen për pastrimin e hapësirave publike dhe grumbullimin e mbeturinave rreth shtratit të lumit. Mirëpo, banorët nuk janë ndihmuar nga komuna në zgjedhjen e problemit të ujërave të zeza dhe largimin e mbeturinave të ngurta.

Edhe këtë vit si problem i trashëguar që nga viti 2013 është përmendur edhe hedhja e mbeturinave mbi fshatin Hogosht. Banorët e Hogoshtit dhe fshatrave tjera vazhdojnë hedhjen e mbeturinave, sidomos atyre të ngurta të ndërtimeve, në shtratin e lumit mbi fshatin Hogosht, rrugës për në Lisockë.

Mbi punësimi në sektorin publik

Një ndër problemet e cekura nga monitoruesit e qeverisjes komunale në Kamenicë është edhe mbi punësimi në sektorin publik. Ky problem është cekur edhe më 2013. Gjatë katër viteve të qeverisjes numri i të punësuarve është rritur nga 1,160 sa ishin më 2013, në 1,199 më 2016. Komuna e Kamenicës ka një të punësuar në administratë për 156 banorë, kurse mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.³ Po ashtu, edhe në sektorin e arsimit, Komuna e Kamenicës ka të mbi punësuar. Raporti nxënës-mësimdhënës në Kamenicë është 12.1, kurse mesatarja në shkallë vendi është 29.9. Numri optimal sipas MASHT duhet të jetë 21. Komuna e Kamenicës i ka edhe së paku 10 të punësuar me kontratë mbi vepër.

³ Instituti GAP. Leternjoftimi i Komunës së Kamenicës 2014. Burimi: <http://bit.ly/2u3K08b> (hapur së fundmi më 2 gusht 2017).

Gjërat që kërkojnë vëmendjen e komunës

Zhvillimi i sportit


Klubi i atletikës "Rogana" është një ndër klubet më të suksesshme të atletikës në Kosovë. Nga shtatë pjesëmarrësit në lojërat olimpike verore "Rio 2016", dy ishin nga klubi i atletikës "Rogana": Musa Hajdari dhe Vijona Kryeziu. Përveq këtyre dy atletëve nga klubi "Rogana", në garat ndërkombëtare merr pjesë edhe Astrit Kryeziu. Por ndihma e komunës për aktivitetet e klubit ka qenë shumë e vogël. Në vitin 2016 klubi "Rogana" ka marr 4,500 euro ndihmë nga komuna.

Përveq klubit të atletikës, komuna e Kamenicës ka edhe katër klube të futbollit të cilat bëjnë gara në liga të ndryshme. Nga ky vit, KF "Bashkimi" dhe KF "Kika" do të bëjnë gara në ligën e parë të futbollit. Ashtu sikurse me atletikën, edhe klubet e futbollit nuk janë mbështetur sa duhet me buxhet nga komuna. Në gjashtë mujorin e parë të 2017, komuna ka shpenzuar vetëm 2,500 euro për rregullimin e terreneve sportive. Kurse në përgjithësi, subvencionet kanë rënë për afër 90%.

Trendet buxhetore të Komunës


Buxheti i Komunës së Kamenicës për vitin 2017 është rreth 7.6 milionë euro në vit. Përveq të hyrave të rregullta, nga viti i kaluar janë bartur të hyra vetanake rreth 372 mijë euro, ndërsa në vitin 2013 ishin bartur rreth 502 mijë euro. Në katër vitet e fundit, kategoria e investimeve kapitale ka shënuar rënie shumë të madhe, nga 1.3 milion euro që ishte më 2013, ka rënë në 124 mijë euro në 2017 (rënie prej 1.2 milion euro apo 90%). Kurse kategoria e pagave dhe mëditjeve është rritur nga 5.3 milionë euro më 2013 në 6.8 milionë euro më 2017. Krahasuar me vitin 2013, numri i të punësuarvë në Komunën e Kamenicës është rritur për 35 persona në vitin 2016. Kategoritë tjera kanë mbetur thuajse të njëjta.

Figura nr.1: Trendet Buxhetore 2013-2017




Nga 17% e buxhetit komunal që ndahet për investime kapitale më 2013, më 2017, kjo ndarje ka rënë në 1.7%. Kamenica zë vendin e fundit në krahasim me komunitet tjera për përqindjen e buxhetit që ndahet për investime kapitale. Pas Kamenicës është Komuna e Parteshit, e cila ndan 3.26% për investime kapitale, pastaj ajo e Novobërdës me 16%. Në mesatare, në vitin 2017 komunitet e Kosovës kanë ndarë rreth 29% të buxhetit për këtë kategori. Në anën tjetër, Komuna e Kamenicës është e para për përqindjen e buxhetit që ndan për paga dhe mëditje. Përderisa në vitin 2017, në mesatare komunitet e Kosovës kanë ndarë 59% të buxhetit për paga dhe mëditje, komuna e Kamenicës ka ndarë 89% të buxhetit për këtë kategori.

Figura nr.2: Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017



Viteve të fundit, të hyrat vetanake të Komunës së Kamenicës kanë ardhur vazhdimisht duke u rritur. Në vitin 2016, kjo komunë ka realizuar 845 mijë euro të hyra apo rreth 204 mijë euro (32%) më shumë se në vitin 2013.

Figura nr.3: Të hyrat vetanake në Komunën e Kamenicës 2013-2017



Sipas vlerësimeve buxhetore, buxheti vjetor i Komunës së Kamenicës nuk pritet të shënojë rritje të madhe as në dy vitet në vijim. Më 2019 parashihet që buxheti total të jetë 8 milionë euro, aq sa ishte më 2015. Sipas Kornizës Afatmesme të

Shpenzimeve të Komunës së Kamenicës për periudhën 2016-2018, të hyrat vetanake dhe shpenzimet pritet të mbesin në nivele të njëjta.

Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Rritjen e investimeve në infrastrukturën shkollore;
- Krijimin e një sistemi të drejtë dhe transparent rekrutues të mësimitdhënësve, si dhe vënien e një praktike të drejtë për mënyrën e ndarjes së orëve mësimore për mësimitdhënësit dhe sistemimin e tyre në shkolla;
- Sigurimi i transportit për nxënësit në fshatrat e thella malore;
- Rrënimin e objekteve të ndërtuara në tokë bujqësore në "rrafshin e Topanicës" dhe ndalimin e ndërtimeve të reja, deri sa Komuna nuk ka plan për këtë zonë;
- Ruajtjen e hapësirave gjelbëruese në qendër të qytetit dhe rrënimi i objekteve pa leje që kanë filluar të ndërtohen në këtë zonë;
- Funkcionalizimin e ujësjellësit në fshatin Koretin dhe përfshirjen e rrjetit të ujësjellësit të këtij fshati dhe fshatrave tjera nën menaxhim të kompanisë rajonale të ujësjellësit "Hidromorava";
- Investime në pastrimin e shtratit të lumit që kalon në fshatrat Berivojcë, Koretin e Topanicë, gjetjen e mundësive për mos derdhjen e ujërave të zeza në lum dhe largimin e kundërmimit;
- Ulja e numrit të të punësuarve në administratën komunale me qëllim të uljes së shpenzimeve për paga dhe mëditje dhe rritje të eficiencës;
- Rritjen e transparencës në rekrutimin e punonjësve me kontrata mbi vepër;
- Ndryshimi i strukturës buxhetore, duke rritur kategorinë e investimeve kapitale dhe duke ulur kategorinë e pagave, subvencioneve, mallrave dhe shërbimeve.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world